



Pranuar / Dorezuar Prilimno / Predato Received / Delivered	27. 11. 2020	0	viti god year
Organ / Institucija Org. / Inst.	Nr. Prot. Br. Prot.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	2891/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A . Nr. 307/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani, dhe Arben Mehmeti, anëtarë, si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.Nr.307/2020, të datës 15.10.2020, të parashtruar nga [REDACTED] me adresë banimi Rr."Lushnja" nr.15 Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike " Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.Nr.307/2020 e datës 15.10.2020 Nr. Protokolli 2105/2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], ka aplikuar në konkursin e datës 23.07.2011 për pozitën Kryeshef Ekzekutiv në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, të publikuar nga Ministria e Administratës Publike, ndërsa më datë 15.10.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimore se gjatë vlerësimit dhe emërimit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar sipas konkursit të datës 23.07.2011 janë bërë shkelje të Ligjit Për Shërbim Civil si dhe të Rregullores Nr.06/2010 për Emërim të Pozitave të Larta Drejtuese në Shërbim Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.10.2020 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme Publike,

ndërsa më datë 09.11.2020, Ministria e Punëve të Brendshme, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 307/2020, të datës 15.10.2020, me numër protokolli 2105/2020 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.10.2020; Raporti i Komisionit për Vlerësimin e Kriterëve i datës 15.09.2011; e-mail i datës 13.10.2020; e-mail i datës 12.10.2020; e-mail i datës 07.10.2020; e-mail i datës 07.10.2020; e-mail i datës 02.10.2020; e-mail i datës 02.10.2020; e-mail i datës 01.10.2020; e-mail i datës 01.10.2020; e-mail i datës 27.08.2020; Pliko me numër 9733963 i datës 13.10.2020; Përgjigje në ankesë e datës 09.11.2020; Konkurs i datës 23.07.2011; Përmbledhja e vlerësimeve individuale i datës 15.09.2011; Vendim i datës 28.09.2011; Dëshmi mbi pranimin e aplikacionit i datës 04.08.2011; Formulari për punësim i kandidatit [REDACTED] [REDACTED] i datës 04.08.2011; CV-ja e kandidatit [REDACTED] [REDACTED] Rekomandim i datës 30.07.2011; Diplomë me numër 2402 e datës 25.01.2010; Certifikatë Themelore Profesionale të Prokurimit e vitit 2011-2013; Certifikatë për kryerjen e kursit të kompjuterëve; Dëshmi mbi pranimin e aplikacionit i datës 05.08.2011; Formulari për punësim i kandidatit [REDACTED] [REDACTED] datës 04.08.2011; Vendim i datës 20.07.2010; Kontratë e Punësimit e datës 01.02.2011; Aneks i Kontratës së Punës i datës 31.12.2009; Vendim me numër 2009/47; Kontratë për Punësim e datës 13.08.2009; Kontrata e Marrëdhënies së Punës i datës 03.07.2006; Kontrata e Marrëdhënies së Punës i datës 10.05.2006; Certifikatë e datës 30.12.1985; Certifikatë e datës 17-21 Janar 2011; Certifikatë e datës 04.07.2011; Certifikatë e datës 11.07.2011; Vendim i datës 03.05.2005; Aktvendim mbi Emërimin e datës 23.03.1987; Certifikatë e datës 13.11.2009; Referencë Pune e datës 11.05.2005; Certifikatë e datës 25.06.2001; Diplomë e datës 1 tetor deri 30 nëntor 2000; Kontratë Pune për Detyra Specifike e datës 07.10.2002; Referencë e datës 16.02.2002; Kontratë Pune për Detyra Specifike e datës 05.11.2001; Referencë e datës 21.09.2001; Letër Referencë e datës 17.11.2009.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të parashtruar nga palët konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejueshme, sepse*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi ka aplikuar në konkursin për Kryeshef Ekzekutiv të Agjencisë Për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar, në Ministrinë e Drejtësisë, i shpallur me datë 23.07.2011, e në të cilën pozitë sipas vlerësimit të Komisionit Përzgjedhës me Vendimin nr.03/2011 të datës 28.09.2011 është emëruar kandidati [REDACTED] [REDACTED].

Me datë 27.08.2020, ankuesi ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme-Administratë Publike, për qasje në dokumentacionin lidhur me procedurën e përzgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv sipas konkursit të datës 23.07.2011. Me datë 07.10.2020 i është mundësuar qasja në dokumentacion sipas kërkesës së tij, pa të drejtën e kopjimit të dokumentacionit. Me datë 15.10.2020, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil me pretendim ankimor se gjatë vlerësimit dhe emërimit të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë sipas konkursit të datës 23.07.2011 janë bërë shkelje të Ligjit Për Shërbim Civil si dhe të Rregullores Nr.06/2010 për Emërim të Pozitave të Larta Drejtuese në Shërbim Civil.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, Kolegji vlerëson se ankesa Nr. 307/2020 e datës 15.10.2020 nr. Protokollit 2105/2020 është parashtruar jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh i përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*.


Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka konstatuar se ankuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të procedurës së ankimit, nuk është lëshuar në shqyrtimin e ligjshmërisë së ankesës se parashtruar nga ankuesi.

Duke marr parasysh se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 129 paragrafi 3 dhe nenin 131 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që ankesa Nr. 307/2020 e datës 15.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED] të hedhet poshtë si e palejuar.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 307/2020**

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi,


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Sekretarit në Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e së Punëve të Brendshme
- Arkivit të KPMSHCK-së